
BURSA SHQIPTARE E ENERGJISË ELEKTRIKE – ALPEX SHA
PASQYRAT FINANCIARE
PËR VITIN E MBYLLUR MË 31 DHJETOR 2024

NUIS: M02223006B

Adresa: Rr. Liman Kaba, Rezidenca Olympic, Shk.3, Kati 1, Zyra nr.1, Tiranë, Shqipëri

Tiranë, më 28/02/2025

PËRMBAJTJA

FAQE

PASQYRAT FINANCIARE :


PASQYRA E POZICIONIT FINANCIAR	1
PASQYRA E FITIMIT OSE HUMBJES DHE TË TË ARDHURAVE GJITHPËRFSHIRËSE	2
PASQYRA E NDRYSHIMEVE NË KAPITAL	3
PASQYRA E FLUKSEVE TË MJETEVE MONETARE	4
SHËNIME MBI PASQYRAT FINANCIARE	5-22

Pasqyra e Pozicionit Financiar më 31 Dhjetor 2024

		Për vitin e mbyllur më 31 Dhjetor 2024	Për vitin e mbyllur më 31 Dhjetor 2023
	Shënimet		
AKTIVET			
Aktive afatgjate			
Asete afatgjata materiale	5	6,520,422	8,276,918
Asete afatgjata jomateriale		-	-
Totali i aktiveve afatgjata		6,520,422	8,276,918
Aktive afatshkurtra			
Inventari	7	800,304	639,125
Llogari të arkëtueshme tregtare	8	117,011,801	88,702,712
Llogari të arkëtueshme e të tjera	8	2,873,182	-
Tatim fitimi		-	-
Parapagimet dhe shpenzimet e shtyra	8	3,330,144	3,335,301
Mjete monetare dhe ekuivalente te tyre	9	1,105,003,517	681,029,411
Totali i aktiveve afatshkurtra		1,229,018,947	773,706,549
Totali i aktiveve		1,235,539,367	781,983,467
Kapitali dhe Rezervat			
Kapitali aksionar	10	250,000,000	250,000,000
Rezerva te tjera	10	877,013	(1,111,663)
Rezerva ligjore		-	-
Fitime të pashpërndara	10	(160,835,328)	(84,618,280)
Fitim/humbje të vitit financiar	21	(37,523,120)	(76,217,048)
Totali i kapitalit		52,518,565	88,053,009
Detyrime afatgjata			
Hua afatgjata		-	-
Grante,të ardhura të shtyra e të tjera detyrime		-	-
Detyrime të tjera afatgjata		-	-
Provizione		-	-
Totali i detyrimeve afatgjata		-	-
Detyrime afatshkurtra			
Huat afashkurte		-	-
Llogari të pagueshme	11	222,459,069	120,929,671
Të pagueshme ndaj punonjësve dhe sig.shoqërore	12	1,020,593	513,119
Detyrime tatimore	13	1,257,007	607,995
Detyrime te tjera te pagueshme	14	958,284,132	571,879,674
Totali i detyrimeve afatshkurta		1,183,020,802	693,930,458
Detyrime totale		1,183,020,802	693,930,458
Totali i kapitalit dhe detyrimeve		1,235,539,367	781,983,467

Pasqyrat financiare duhet të lexohen së bashku me shënimet shpjeguese të faqeve 5 - 22, të cilat janë pjesë përbërëse e këtyre pasqyrave financiare.

Z. Sokol Dishnica
Administratori i ALPEX SHA



Znj. Irena Sinani
Drejtoreshë e Drejtorisë së Klerimit dhe Financës



Pasqyra e Fitimit ose Humbjes dhe Të Ardhurave të tjera gjithpërfshirëse më 31 Dhjetor 2024


		Për vitin e mbyllur më 31 Dhjetor 2024	Për vitin e mbyllur më 31 Dhjetor 2023
Të ardhura nga aktiviteti i shfrytëzimit	15	65,670,136	46,547,036
Të ardhura të tjera	15	-	-
Total të ardhura		65,670,136	46,547,036
Shpenzime për materiale	16	(1,375,665)	(899,615)
Shpenzime për personelin	17	(34,033,148)	(26,965,070)
Shpenzime amortizimi	18	(1,992,213)	(2,442,342)
Shpenzime të tjera të shfrytëzimit	19	(62,266,260)	(89,238,138)
Total shpenzime		(99,667,286)	(119,545,165)
Te ardhura financiare	20	213,053,169	50,586,075
Shpenzime financiare	20	(216,579,138)	(53,804,994)
Fitimi/humbja para tatimit	21	(37,523,120)	(76,217,048)
Shpenzimi i tatimit mbi fitimin			-
Shpenzimi aktual i tatimit mbi fitimin		-	-
Shpenzimi aktual i tatimit të shtyrë		-	-
Fitimi/humbja e vitit	21	(37,523,120)	(76,217,048)
Fitimi/humbja per:			
Pronaret e njesise ekonomike meme	57.25%	(21,481,986)	(43,634,260)
Interesat jo-kontrolluese	42.75%	(16,041,134)	(32,582,788)
Rezerva përkthimi		1,988,676	(637,639)
Totali i të ardhurave të tjera gjithpërfshirëse për vitin		1,988,676	(637,639)
Totali i të ardhurave gjithpërfshirëse për vitin		(35,534,444)	(76,854,687)
Totali i te ardhurave/humbjeve gjithpërfshirëse per:			
Pronaret e njesise ekonomike meme	57.25%	(20,343,469)	(43,999,309)
Interesat jo-kontrolluese	42.75%	(15,190,975)	(32,855,379)

Pasqyrat financiare duhet të lexohen së bashku me shënimet shpjeguese të faqeve 5 - 22, të cilat janë pjesë përbërëse e këtyre pasqyrave financiare.

Z. Sokol Dishnica
 Administrator i ALPEX SHA



Znj. Irena Sinani
 Drejtore e Drejtorisë së Klerimit
 dhe Financës



Pasqyra e Ndryshimeve në Kapital më 31 Dhjetor 2024

Pozicioni financiar në fillim 01 Janar 2023	Kapitali i nënshkruar	Primi i lidhur me rritjesi kapitalin	Rezerva mi	Rezerva tjera	Diferenca nga përkthimi i monedhës në	Fitimet/ (humbjet) e pashpërndara	Fitim/(humbja) e periudhës	Totali	Interesa jo-kontrollu	Totali
Efekt i ndryshimeve në politikat kontabile	250,000,000.00	-	-	-	(474,024)	(32,601,526)	(52,016,754)	164,907,696	-	164,907,696
Pozicioni financiar i rideklaruar në fillim	250,000,000.00	-	-	-	(474,024)	(32,601,526)	(52,016,754)	164,907,696	-	164,907,696
Të ardhurat totale gjithëpërfshirëse të periudhës:										
Fitim/(humbja) e periudhës	-	-	-	-	-	-	-	-	-	-
Të ardhura të tjera gjithëpërfshirëse	-	-	-	-	-	-	-	-	-	-
Tatime aktuale dhe të shtyra të njohura drejtpërdrejt në	-	-	-	-	(637,639)	-	-	(76,217,048)	(76,217,048)	(76,217,048)
Totali i të ardhurave gjithëpërfshirëse për periudhën	-	-	-	-	(637,639)	-	(76,217,048)	(76,854,687)	-	(76,854,687)
Transaksione për pronarët e njësisë ekonomike të										
Emetim i kapitalit të nënshkruar	-	-	-	-	-	-	-	-	-	-
Transaksione miratimi rezultatit	-	-	-	-	-	(52,016,754)	52,016,754	-	-	-
Dividende të shpërndarë	-	-	-	-	-	-	-	-	-	-
Totali i transaksioneve për pronarët e njësisë	-	-	-	-	-	(52,016,754)	52,016,754	-	-	-
Pozicioni financiar në fund (viti paraardhës)	250,000,000.00	-	-	-	(1,111,664)	(84,618,280)	(76,217,048)	88,053,009	-	88,053,009
Pozicioni financiar në fillim 01 Janar 2024	250,000,000.00	-	-	-	(1,111,664)	(84,618,280)	(76,217,048)	88,053,009	-	88,053,009
Efekt i ndryshimeve në politikat kontabile	250,000,000.00	-	-	-	(1,111,664)	(84,618,280)	(76,217,048)	88,053,009	-	88,053,009
Pozicioni financiar i rideklaruar në fillim	250,000,000.00	-	-	-	(1,111,664)	(84,618,280)	(76,217,048)	88,053,009	-	88,053,009
Të ardhurat totale gjithëpërfshirëse të periudhës:										
Fitim/(humbja) e periudhës	-	-	-	-	-	-	-	-	-	-
Të ardhura të tjera gjithëpërfshirëse	-	-	-	-	-	-	-	-	-	-
Sisteme drejtpërdrejt në kapital	-	-	-	-	2,290,996	(302,319)	(37,523,120)	2,290,996	(37,523,120)	(37,523,120)
Totali i të ardhurave gjithëpërfshirëse për periudhën	-	-	-	-	1,988,677	-	(37,523,120)	(35,534,443)	-	(35,534,443)
Transaksione për pronarët e njësisë ekonomike të										
Emetim i kapitalit të nënshkruar	-	-	-	-	-	(76,217,048)	76,217,048	-	-	-
Transaksione miratimi rezultatit	-	-	-	-	-	-	-	-	-	-
Dividende të shpërndarë	-	-	-	-	-	-	-	-	-	-
Totali i transaksioneve për pronarët e njësisë	-	-	-	-	-	(76,217,048)	76,217,048	-	-	-
Pozicioni financiar në 31/12/2024	250,000,000.00	-	-	-	877,013	(160,835,328)	(37,523,120)	52,518,565	-	52,518,565

Pasqyrat financiare duhet të lexohen së bashku me shënimet shpjeguese të faqeve 5 - 22, të cilat janë pjesë përbërëse e këtyre pasqyrave financiare.

Z. Sokol Dishnica
Administrator i ALPEX SHA



Znj. Irena Sinani
Drejtoresh e Drejtorisë së Klerimit dhe Financës



Pasqyra e Fluksit të Mjeteve Monetare më 31 Dhjetor 2024


	Për vitin e mbyllur më 31 Dhjetor 2024	Për vitin e mbyllur më 31 Dhjetor 2023
Fluksi mjeteve monetare nga/perdorur ne aktivitetin e shfrytëzimit:		
Flukset e parasë nga aktivitetet operative		
Fitimi para tatimit	(37,523,120)	(76,217,048)
Axhustime për zërat jo-monetare:		
Shpenzime amortizimi	1,992,213	2,442,342
Shpenzime zhvlerësimi		
(Të ardhura)/humbje nga shitja e Aktiveve Afatgjata Materiale		-
Nxjerrja jashtë përdorimit e Mjeteve fikseve, neto nga fitimi kapital		
Pakësime të tjera Aktive Afatgjata Materiale		
Interesa të përlllogaritura		
Shpenzime për interesa		
Fitimi operativ përpara ndryshimeve në kapitalin qarkullues	(35,530,906)	(73,774,706)
Ndryshimi në kapitalin qarkullues		
Ndryshimi në inventar	175,566	410,947
Ndryshimi në llogari të arkëtueshme dhe të tjera	(31,182,270)	(85,389,325)
Ndryshimi në llogari të pagueshme dhe të tjera	489,090,343	692,244,745
Ndryshimi në parapagime e shpenzime të shtyra	5,157	
Mjetet monetare të gjeneruara nga aktivitetet operative	458,088,796	607,266,367
Interesa të paguara		
Tatimi i paguar mbi dividendin		
Tatimi mbi fitimin i paguar gjatë vitit		
Aktivitetet investuese		
Blerje të aktiveve afatgjata materiale	(572,461)	(1,273,874)
Asete financiare	-	3,116
Blerje të aktiveve afatgjata jomateriale		
Shitje e aktiveve afatgjata materiale		
(Blerje)/shitje e shoqërisë së kontrolluar minus paratë e arkëtuara		
Dalja për parapagime për asete	-	
Mjete monetare të gjeneruara nga aktiviteti investues	(572,461)	(1,270,758)
Aktivitetet financuese		
(Ripagim)/ të hyrat neto nga huatë afatgjata		
(Ripagim)/ të hyrat neto n-Kontribut ne kapital		-
(Ripagim)/ të hyra nga hua afatshkurtër		
(Ripagim)/ të hyra nga detyrime për qira financiare		
Dividendë paguar		
Mjete monetare të gjeneruara nga aktiviteti financues		-
Ndryshimi neto i mjeteve monetare	421,985,428	532,220,903
Mjetet monetare në fillim të periudhës	681,029,411	149,446,147
Diferenca përkthimi	1,988,677	(637,639)
Mjetet monetare në fund të periudhës	1,105,003,517	681,029,411

Pasqyrat financiare duhet të lexohen së bashku me shënimet shpjeguese të faqeve 5 - 22, të cilat janë pjesë përbërëse e këtyre pasqyrave financiare

Z. Sokol Dishnica
Administrator i ALPEX SHA



Znj. Irena Sinani
Drejtore e Drejtorisë së Klerimit dhe
Financës



1. Informacion i përgjithshëm

Shoqëria Bursa Shqiptare e Energjisë Elektrike – ALPEX sh.a. (më poshtë referuar si "Shoqëria") është regjistruar pranë Qendrës Kombëtare të Regjistrimit me datë 23 Tetor 2020 me NUIS M02223006B. Veprimtaria e Shoqërisë rregullohet në përputhje me dispozitat përkatëse të Ligjit 9901, datë 14 Prill 2008, "Për Tregtarët dhe Shoqëritë Tregtare", si dhe nga Marrëveshja e Aksionareve dhe Statuti i Shoqërisë. Objekti kryesor i aktivitetit të Shoqërisë është krijimi, menaxhimi dhe administrimi i tregut të organizuar të energjisë elektrike, nëpërmjet platformës së tregut në bazë të ditës në avancë dhe brenda së njëjtës ditë. Shoqëria zotërohet nga aksionarët Operatori i Sistemit të Transmetimit OST sh.a. dhe Operatori i Sistemit të Transmisionit dhe Tregu – KOSTT sh.a., të cilët zotërojnë respektivisht 57.25% dhe 42.75% të kapitalit themeltar.

Më dt. 06.05.2021 u regjistrua Bursa Shqiptare e Energjisë Elektrike SHA – Dega në Kosovë me NUIS 811568495, me adresë Rr. Isa Boletini, nr.39, Prishtinë, Kosovë. Veprimtaria e Degës në Kosovë, rregullohet në përputhje me dispozitat e Ligjit Nr.02/L-123 mbi Shoqëritë Tregtare. Themelues dhe Pronar është Bursa Shqiptare e Energjisë Elektrike – ALPEX Sh.a. me 100% të aksioneve, dhe përfaqësohet nga Z. Sokol Dishnica, në cilësinë e Drejtorit Menaxhues.

Numri i punonjësve të Shoqërisë më 31 Dhjetor 2024 është 17, në Zyrat Qëndrore në Tiranë 13 punonjës dhe në Degën në Kosovë 4 punonjës.

Kapitali i Shoqërisë është 250,000,000 Lekë, i ndarë në 250,000 (dyqind e pesëdhjetë mijë) aksione me vlerë nominale 1,000.00 (një mijë) Lekë secila.

Kapitali i Shoqërisë zotërohet nga aksionerët:

Aksioneri	Numri i Aksioneve	% e Kapitalit
OST sh.a	143,125	57.25%
KOSTT sh.a	106,875	42.75%
		100%

Organet drejtuese të Shoqërisë janë Asambleja e Përgjithshme, Këshilli Mbikqyrës dhe Administratori.

Këshilli Mbikqyrës përbëhet nga:

- Z. Shyqeri Morina
- Z. Altin Petre
- Znj. Kledia Ngjela
- Znj. Ilda Nushi
- Z. Genc Sejdiu

Përfaqësuesi Ligjor i Shoqërisë nga data 05/10/2020 - 06/12/2026 është Z.Sokol Dishnica.

Këto Pasqyra Financiare janë paraqitur për periudhën e mbyllur më 31 Dhjetor 2024 duke përfshirë Degën në Kosovë.

2. Bazat e përgatitjes

2.1 Deklarata e pajtueshmërisë

Pasqyrat financiare janë përgatitur në përputhshmëri me Standardet Ndërkombëtare të Raportimit Financiar (SNRF) të aprovuara nga Bordi për Standarde Ndërkombëtare të Kontabilitetit (“BSNK”), si dhe në përputhje me Ligjin Nr. 25/2018 datë 10.05.2018, “Për Kontabilitetin dhe Pasqyrat Financiare” dhe Standartet Kombëtare të Kontabilitetit të përmirësuara të shpallura me urdhërin e Ministrit të Financave nr. 64 datë 22.07.14 “Për shpalljen e detyrueshme të tyre”.

2.2 Baza e matjes

Pasqyrat financiare janë përgatitur bazuar në koston historike. Informacioni kontabël përpunohet në Software Financiar.

2.3 Biznesi në vijimësi

Pasqyrat financiare të Shoqërisë përgatiten mbi supozimin e biznesit në vijimësi. Shoqëria ka rezultuar me humbje edhe për këtë vit kontabël për shumën prej 198.40 milion lek, por është qëllimi dhe politika e aksionerëve të shoqërisë që t’i sigurojnë asaj gjithë mbështetjen financiare që mund të nevojitet për të mbajtur nivelin e kapitalit dhe likuiditetit në nivele të tilla që të përmbushi detyrimet e saj në përputhje me parimin e vijimësisë të përshtatshëm për aktivitetet e saj. Aksionerët angazhohen që ta mbështesin financiarisht shoqërinë për sigurimin e vijimësisë.

2.4 Monedha funksionale dhe e paraqitjes

Këto pasqyra financiare janë prezantuar në Lek Shqiptar “Lekë”, e cila është monedha funksionale e Shoqërisë.

2.5 Vlerësime dhe gjykime

Paraqitja e pasqyrave financiare sipas SNRF-ve kërkon që menaxhimi i shoqërisë të kryejë vlerësime dhe supozime që ndikojnë shumat e raportuara të aktiveve, detyrimeve dhe aktiveve e detyrimeve të kushtëzuara në datën e pasqyrës së pozicionit financiar, si dhe të ardhurave dhe shpenzimeve të krijuara në periudhën kontabël.

Vlerësimet dhe gjykimet rishikohen vazhdimisht dhe bazohen në eksperiencën e mëparshme dhe faktorë të tjerë duke përfshirë pritshmëritë për ngjarjet e ardhshme të cilat besohen të jenë të arsyeshme në rrethanat aktuale. Në disa raste menaxhimi mbështetet në mendimet e ekspertëve të pavarur. Fushat të cilat kërkojnë një shkallë më të lartë gjykimi, që kanë një shkallë të lartë kompleksiteti janë përshkruar në shënimet e pasqyrave financiare.

3. Aplikimi i Standardeve Ndërkombëtare të Raportimit Financiar të reja dhe të rishikuara (SNRF)

Politikat e adoptuara të kontabilitetit janë në përputhje me ato të vitit të kaluar financiar. Ndryshimet që rrjedhin nga përmirësimet në SNRF nuk kanë ndonjë ndikim në politikat kontabël, pozicionin financiar apo në ecurinë e Shoqërisë. Një numër standardesh të reja, ndryshime në standarde dhe interpretime nuk janë ende efektive për vitin e mbyllur më 31 Dhjetor 2024, dhe nuk janë aplikuar më herët në përgatitjen e këtyre pasqyrave financiare.

3.1 Standardet dhe interpretimet efektive në periudhën aktuale

Ndryshimet e mëposhtme në standardet ekzistuese dhe interpretimi i ri i lëshuar nga Bordi i Standardeve Ndërkombëtare të Kontabilitetit (BSNK), janë në fuqi për periudhën raportuese:

- **Ndryshime në IFRS 16 (Qiratë):**Detyrimi i Qirasë në një Transaksion Shitje dhe Qira, ndryshime për të sqaruar se si një shitës-qiramarrës mat në vazhdim transaksionet e shitjes dhe kthimit me qira. Ndryshimet bëhen efektive më 1 Janar 2024.
- **Ndryshime në IAS 1 (Prezantimi i Pasqyrave Financiare):**Klasifikimi i detyrimeve si afatshkurter ose afatgjate dhe klasifikimi i detyrimeve afatgjate me marrëveshje. Ndryshimet bëhen efektive më 1 Janar 2024.
- **Ndryshimet në SNK 7 Pasqyra e Flukseve të Parasë dhe SNRF 7 Instrumentet Financiare:** Dhënia e informacioneve shpjeguese mbi Marrëveshjet financiare të furnizuesit. Ndryshimet bëhen efektive më 1 Janar 2024.
- **IFRS S1 - Kërkesat e Përgjithshme për Shpalosjen e Informacionit Financiar të Lidhura me Qëndrueshmërinë në Financat**** Ndryshimet bëhen efektive më 1 Janar 2024.
- **IFRS S2 - Dhënia e informacioneve shpjeguese të lidhura me klimën.** Ndryshimet bëhen efektive më 1 Janar 2024.

Zbatimi i këtyre standardeve të reja, ndryshimeve të standardeve ekzistuese dhe interpretimeve nuk sjellë ndonjë ndryshim material në këto pasqyra financiare.

3.2 Standardet dhe interpretimet e standardeve ekzistuese që nuk janë ende në fuqi dhe nuk janë miratuar më herët nga Shoqëria

Në datën e autorizimit të këtyre pasqyrave financiare, standardet e reja të mëposhtme, ndryshimet në standardet ekzistuese dhe interpretimi i ri ishin publikuar, por ende jo në zbatim:

- **Ndryshime në SNK 21 Efektet e ndryshimeve në kurset e këmbimit valutor** :Mungesa e këmbyeshmërisë, i referohet një situatë ku nuk ka treg ose kurs këmbimi të vëzhgueshëm për konvertimin e një monedhe në një tjetër. Ndryshimet bëhen efektive më 1 Janar 2025.
- **Ndryshime në IFRS 9 (Instrumentet Financiare) dhe IFRS 7 (Instrumentet Financiare):**Ndryshime në flasifikimin dhe datjen e instrumenteve financiare, dhënia e informacioneve shpjeguese. Ndryshimet bëhen efektive më 1 Janar 2026.
- **Përmirësimet vjetore të standardeve të kontabilitetit SNRF – Ndryshimet në:SNRF 1 Miratimi për herë të parë i Standardeve Ndërkombëtare të Raportimit Financiar;SNRF 7 Instrumentet Financiare:** Dhënia e informacioneve shpjeguese dhe udhëzimi shoqërues për zbatimin e SNRF 7; SNRF 9 Instrumentet Financiare; SNRF 10 Pasqyrat Financiare të Konsoliduara; dhe SNK 7 Pasqyra e flukseve monetare. Ndryshimet bëhen efektive më 1 Janar 2026.
- **SNRF 18 Paraqitja dhe Shpalosja në Pasqyrat Financiare.** Ndryshimet bëhen efektive më 1 Janar 2027.
- **SNRF 19 Filialet pa Përgjegjësi Publike:** Dhënia e informacioneve shpjeguese. Ndryshimet bëhen efektive më 1 Janar 2027.

Shoqëria ka zgjedhur të mos adoptojë këto standarde të reja, ndryshimet në standardet ekzistuese dhe interpretimet e reja përpara datës kur ato do të bëhen efektive. Shoqëria parashikon se adoptimi i këtyre standardeve të reja, ndryshimet në standardet ekzistuese dhe interpretimet e reja nuk do të kenë ndikim material në pasqyrat financiare të Shoqërisë në periudhën e aplikimit fillestar të tyre.

4. Politika Kontabël të rëndësishme

Shoqëria ka aplikuar në mënyrë të qëndrueshme politikat e mëposhtme kontabël për të gjitha periudhat e paraqitura në këto pasqyra financiare:

4.1. Transaksionet në monedhë të huaj

Transaksionet në monedhë të huaj konvertohen në monedhën funksionale dhe regjistrohen me kursin e këmbimit në datën e transaksionit.

Aktivitet dhe detyrimet monetare në monedhë të huaj në datën e raportimit konvertohen në monedhën funksionale me kursin e këmbimit në datën e raportimit. Fitimi ose humbja nga këmbimi në zërat monetarë është diferenca që vjen nga këmbimi i një numri të caktuar njësish të një monedhe të huaj në monedhën funksionale me kurse të ndryshme këmbimi në datat e këmbimit. Të drejtat dhe detyrimet jo-monetare në monedhë të huaj konvertohen në monedhën funksionale me kursin e këmbimit të datës së kryerjes së transaksionit ndërsa ato që maten me vlerë të drejtë rikëmben në monedhën funksionale me kursin e këmbimit të datës kur është përcaktuar vlera e drejtë. Diferencat që rezultojnë nga kursi i këmbimit kalojnë në pasqyrën e të ardhurave dhe shpenzimeve.

Kursi i këmbimit i monedhave të huaja më 31 Dhjetor 2024 dhe 31 Dhjetor 2023 është detajuar si më poshtë:

Monedha	Kursi mesatar 2024	Kursi i raportimit 2024	Kursi mesatar 2023	Kursi i raportimit 2023
ALL / EUR	100.70	98.15	108.75	103.88

4.2. Instrumentat financiare

Instrumentat financiare joderivative përbëhen nga llogari të arkëtueshme, mjete monetare dhe llogari të pagueshme. Instrumentat financiare joderivative njihen fillimisht me vlerën e drejtë plus çdo kosto transaksioni që lidhet me to, përveç siç përshkruhet më poshtë. Për instrumentat e mbajtur me vlerë të drejtë nëpërmjet fitim/humbje, kostot e transaksionit kalojnë në shpenzime dhe të ardhura. Në vijim të njohjes fillestare instrumentat financiare joderivative maten siç përshkruhet më poshtë. Një instrument financiar njihet nëse Shoqëria bëhet palë në kushtet kontraktuale të instrumentit. Aktivitet financiar regjistrohen kur skadojnë të drejtat kontraktuale të Shoqërisë mbi flukset e parasë së aktivitetit financiar ose kur Shoqëria transferon aktivin financiar tek një palë e tretë pa mbajtur kontrollin ose gjithë risqet dhe përfitimet thelbësore të aktivitetit. Blerjet dhe shitjet normale të aktiveve financiare kontabilizohen në datën e transaksionit, që është data në të cilën Shoqëria angazhohet të blejë apo të shesë aktivin. Detyrimet financiare regjistrohen nëse detyrimet kontraktuale të Shoqërisë skadojnë, shfuqizohen ose anulohen.

i. Paraja dhe ekuivalentët e parasë

Paraja dhe ekuivalentët e parasë (mjetet monetare) përbëhen nga paratë në arkë, dhe paratë në bankë.

ii. Llogari të arkëtueshme

Llogaritë e arkëtueshme (kërkesat e arkëtueshme) njihen fillimisht me vlerën e drejtë dhe më pas me kosto të amortizuar duke zbritur humbjen nga zhvlerësimi.

iii. Llogari të pagueshme

Llogaritë e pagueshme paraqiten me vlerën e tyre të drejtë dhe më pas me kosto të amortizuar, duke përdorur metodën e interesit efektiv.

4.3 Inventarët

Inventarët regjistrohen në kontabilitet me vlerën më të ulët mes koston dhe vlerës së realizueshme neto. Kosto e marrjes përfshin të gjitha shpenzimet e kryera për ta sjellë inventarin në vendin dhe kushtet ekzistuese. Kosto e inventarit llogaritet duke përdorur metodën e mesatares së ponderuar. Vlera e realizueshme neto është çmimi i shitjes i përlllogaritur gjatë rrjedhës normale të biznesit minus koston e përlllogaritura për përfundimin dhe realizimin e shitjeve. Gjendjet e inventarit janë të vlerësuara në bilanc me koston e tyre historike, duke e konsideruar këtë vlerësim, si vlerën më të ulët midis koston dhe vlerës neto të realizueshme.

4.4. Aktive afatgjata materiale

i. Njohja dhe matja

Të gjitha aktivet afatgjata materiale paraqiten me kosto duke zbritur zhvlerësimin dhe amortizimin e akumuluar. Kostoja përfshin shpenzime të cilat lidhen drejtpërdrejt me blerjen e aktivit. Në rastet kur pjesë të një aktivi afatgjatë material kanë jetëgjatësi të ndryshme, ato kontabilizohen si zëra të ndryshëm (komponentët më të mëdhenj) të aktiveve afatgjata materiale. Fitimet dhe humbjet nga shitjet apo nxjerrjet jashtë përdorimit përcaktohen duke krahasuar vlerën e shitjes me vlerën e mbetur, dhe këto përfshihen në pasqyrën e të ardhurave dhe shpenzimeve.

ii. Kostot e mëpasshme

Kostoja e zëvendësimit të një pjese të një zëri të aktiveve afatgjata materiale njihet në vlerën kontabël të atij zëri nëse është e mundshme që Shoqëria do të realizojë përfitime të ardhshme ekonomike nga përdorimi i pjesës zëvendësuese dhe kostoja e pjesës mund të matet në mënyrë të besueshme. Kostot e shërbimeve të zakonshme të aktiveve afatgjata materiale njihen si shpenzime kur ato ndodhin.

iii. Amortizimi

Amortizimi i aktiveve llogaritet duke marrë për bazë periudhën më të shkurtër midis afatit të aktivitetit dhe jetës së vlerësuar të dobishme të aktivitetit duke filluar nga dita kur ai është i gatshëm për përdorim. Aktivitetet e marra me qira financiare amortizohen duke marrë për bazë periudhën më të shkurtër midis periudhës së qirasë dhe jetës së dobishme të aktivitetit. Pikturat sendet me vlerë nuk amortizohen. Metodatat e amortizimit dhe përqindjet përkatëse sipas grupeve të aktiveve afatgjata për periudhën aktuale janë si më poshtë:

Kategoria e Aktiveve	Metodat e Amortizimit		Norma e Amortizimit	
	2024	2023	2024	2023
Ndërtesa	Lineare	Vlera e mbetur	5%	5%
Makineri dhe pajisje	Lineare	Vlera e mbetur	20%	20%
Mobilje dhe orendi	Lineare	Vlera e mbetur	20%	20%
Mjete transporti	Lineare	Vlera e mbetur	20%	20%
Pajisje informatike	Lineare	Vlera e mbetur	25%	25%

iv. Çregjistrimi

Një zë i aktiveve afatgjata materiale çregjistrohet kur ai nxirret jashtë përdorimit apo atëherë kur nuk priten më përfitime ekonomike të ardhshme nga përdorimi apo nxjerrja e tij jashtë përdorimit.

Fitimet dhe humbjet në rastin e nxjerrjes jashtë përdorimit të aktiveve afatgjata materiale, përcaktohen sipas shumës së tyre të mbetur dhe merren parasysh në nxjerrjen e rezultatit operativ të vitit.

4.5. Aktivet Afatgjata Jomateriale

Aktivitetet afatgjata jomateriale që kanë një jetë të përcaktuar maten me kosto duke zbritur amortizimin e akumuluar dhe humbjet e akumuluar nga zhvlerësimi. Amortizimi llogaritet

mbi koston e blerjes së aktivit të zvogëluar me vlerën e tij të mbetur. Shuma e amortizimit kalon në pasqyrën e të ardhurave dhe shpenzimeve në mënyrë zbritëse përgjatë jetës së aktivit.

4.6. Aktive në përdorim

Shoqëria njeh të drejtën e përdorimit të një aktivi dhe një detyrim qiraje në datën e fillimit të qirasë.

Aktivi me të drejtën e përdorimit fillimisht matet me kosto, i cili përfshin shumën fillestare të detyrimit të qirasë të rregulluar për çdo pagesë qiraje të bërë në ose para datës së fillimit, plus çdo shpenzim fillestar të drejtpërdrejtë të kryer dhe një vlerësim të kostove për çmontimin dhe largimin ose rivendosjen e aktivit ose zonës së vendndodhjes në të cilën është, duke zbritur cdo përfitim të marrë.

Aktivi me të drejtë përdorimi amortizohet më pas duke përdorur metodën lineare nga data e fillimit deri në fund të jetës së dobishme të aktivit ose në fund të afatit të qirasë financiare.

4.7. Aktive jo financiare

Vlerat kontabël të aktiveve jofinanciare të Shoqërisë janë rishikuar në datën e raportimit për të përcaktuar në qoftë se ka ndonjë tregues zhvlerësimi. Në qoftë se ndonjë tregues i tillë ekziston, atëherë llogaritet vlera e rikuperueshme e aktivit. Shuma e rikuperueshme është vlera më e lartë midis vlerës së drejtë minus kostot e shitjes dhe vlerës në përdorim. Në vlerësimin e vlerës në përdorim, flukset e vlerësuarat monetare të ardhshme janë zbritur për vlerën e tyre aktuale duke përdorur një normë skontimi para taksave që reflekton vlerësimet aktuale të tregut për vlerën në kohë të parasë dhe risqet specifike për aktivin për të cilat vlerësimet e flukseve monetare të ardhshme nuk janë rregulluar.

Humbjet nga zhvlerësimi njihen në qoftë se vlera e mbartur e aktivit apo pjesa e burimit të parave e kalon vlerën e rikuperueshme. Humbjet nga zhvlerësimi janë njohur në të ardhura ose shpenzime.

4.8. Kapitali aksionar

Aksionet e zakonshme klasifikohen si kapital. Kapitali aksionar njihet me vlerën nominale.

4.9. Dividendët

Shpërndarja e dividendëve për aksionerët njihet në pasqyrat financiare të shoqërisë si detyrim në periudhën në të cilën janë aprovuar nga aksionerët e Shoqërisë.

4.10. Të ardhurat

Të ardhurat janë flukset hyrëse bruto të përfitimeve ekonomike lindur në rrjedhën normale të aktiviteteve të shoqërisë që rezultojnë në rritje të kapitalit neto gjatë periudhës dhe nuk përfshijnë rritjet e kapitalit neto në saj të kontributeve të ortakëve. Të ardhurat përfshijnë vlerën e drejtë të shumës së arkëtuar apo të arkëtueshme kryesisht nga tarifat e tregtimit në rrjedhën normale të aktiviteteve të shoqërisë. Të ardhurat nuk përfshijnë tatimin e vlerës së shtuar, kthimet, skontot dhe zbritjet, nëse ka. Të ardhurat nga shërbimet e ofruara njihen në pasqyrën e të ardhurave dhe shpenzimeve në varësi të fazës së përfundimit të transaksionit në datën e raportimit. Asnjë e ardhur nuk njihet nëse ka pasiguri të lartë lidhur me kryerjen e pagesës dhe kostove përkatëse.

4.11. Të ardhurat dhe shpenzimet financiare

Të ardhurat financiare përfshijnë të ardhurat nga interesi për llogaritë bankare dhe fitime nga kursi i këmbimit që njihen në pasqyrën e të ardhurave dhe shpenzimeve. Të ardhurat nga interesi njihen mbi bazën e të drejtave dhe detyrimeve të konstatuara duke përdorur metodën e interesit efektiv. Shpenzimet financiare përfshijnë shpenzime interesi mbi huamarrjet dhe humbjet nga kursi i këmbimit, ndryshimet në vlerën e drejtë të aktiveve financiare të mbajtura

me vlerë të drejtë nëpërmjet llogarisë fitim/humbje, dhe humbjet nga zhvlerësimi i aktiveve financiare. Kostot e huamarrjes njihen në pasqyrën e të ardhurave dhe shpenzimeve me metodën e interesit efektiv.

4.12. Tatimi mbi fitimin

Tatim fitimi i vitit përbëhet nga tatimi aktual dhe tatim fitimi i shtyrë. Tatim fitimi njihet në pasqyrën e të ardhurave dhe shpenzimeve përveç rasteve kur lidhet me zëra që njihen direkt në kapital, rast në të cilin edhe tatimi njihet në kapital.

Tatimi aktual është tatimi i pritur për t'u paguar mbi fitimin e tatueshem të vitit, duke aplikuar normat tatimore në fuqi në datën e bilancit, si dhe çfarëdolloj rregullimi kontabël të tatimit për t'u paguar në lidhje me vitet e mëparshme. Norma e tatimit mbi fitimin për vitin 2024 është 15% (2023:15%).

Tatim fitimi i shtyrë përfaqëson diferencën e tatimit mbi fitimit të pagueshëm (apo të rikuperueshëm) në periudhat e ardhshme, i cili përlllogaritet për të evidentuar diferencat e përkohshme që krijohen për shkak të aplikimit të parimeve kontabël të ndryshme nga ato tatimore.

Tatimi i shtyrë njihet sipas metodës së detyrimeve të bilancit, duke aplikuar normën tatimore në fuqi mbi diferencën ndërmjet aktiveve dhe detyrimeve për qëllime të raportimit financiar dhe vlerave të këtyre aktiveve dhe detyrimeve për qëllime tatimore.

Gjendjet e shtyra tatimore maten me normat tatimore në fuqi ose që konsiderohen në fuqi në fund të periudhës së raportimit, të cilat pritet të zbatohen për periudhën kur diferencat e përkohshme do të anulohen ose humbja tatimore e mbartur do të shfrytëzohet.

4.13. Fondet për pensione

i. Fondet e sigurimeve shoqërore dhe të shëndetit

Sipas legjislacionit të Republikës së Shqipërisë dhe legjislacionit të Republikës së Kosovës vetëm për kontributet e sigurimeve shoqërore, në fuqi shoqëria është e detyruar të kryejë kontribute fikse për llogari të punonjësve në një fond të administruar nga Qeveria. Të gjitha këto pagesa/detyrime njihen si shpenzim në periudhën të cilës i përkasin.

ii. Përfitimet në përfundim të marrëdhënieve të punës

Përfitimet në përfundim të marrëdhënieve të punës njihen si shpenzim kur shoqëria është e angazhuar dukshëm, pa mundësi reale tërheqjeje dhe kur njeh kosto rishërtimi. Nëse përfitimet nuk pritet të zgjidhen tërësisht brenda 12 muajve nga data e raportimit, atëherë ato skontojnë.

iii. Fondet e pensionit vullnetar

Plani i Pensionit Vullnetar për punonjësit e Shoqërisë realizohet nëpërmjet aderimit në Fondin e Pensioneve Vullnetare me qëllim sigurimin e përfitimeve pensionale suplementare për të gjithë punonjësit e Shoqërisë nën një kontratë të rregullt pune. Është një plan pensioni me kontribute të përcaktuara dhe me pjesëmarrje të përbashkët të pa kushtëzuar punëdhënës-punëmarrës. Masa e kontributit që Shoqëria paguan për çdo punonjës është në përqindje të masës së kontribuar nga punëmarrësi por jo më shumë se 10% mbi pagën mujore bazë.

4.14. Transaksionet me palët e lidhura

Palët e lidhura përcaktohen kur një palë kontrollohet nga pala tjetër, ose ka ndikim të rëndësishëm në vendimet e biznesit apo vendimet financiare të palës tjetër. Për qëllime të paraqitjes së pasqyrave financiare, drejtimi i shoqërisë dhe manaxhimi konsiderohen si palë të lidhura.

4.15. Provizione

Një provizion njihet nëse, si rezultat i një ngjarjeje të shkuar, Shoqëria ka një detyrim ligjor apo konstruktiv, i cili mund të vlerësohet në mënyrë të besueshme dhe do të kërkojë në të ardhmen flukse dalëse parash për shlyerjen e tij. Provizionet përcaktohen duke skontuar flukset e pritshme të ardhshme të parasë me një normë skontimi para tatimit që pasqyron vlerësimet aktuale të tregut për vlerën në kohë të parasë dhe për risqet që lidhen me detyrimin në fjalë. Provizionet rishikohen në çdo datë raportimi dhe nëse nuk ka më gjasa për daljen e ndonjë fluksi parash për shlyerjen e detyrimit, provizionet rimerren.

4.16. Aktivet dhe detyrimet e kushtëzuara

Detyrimet e kushtëzuara nuk njihen në pasqyrat financiare. Ato paraqiten në shënime të pasqyrave financiare për sa kohë që mundësia për një dalje të burimeve që përfshijnë përfitime ekonomike është e largët. Një aktiv i kushtëzuar nuk paraqitet në pasqyrat financiare por paraqitet në shënime për sa kohë ekziston mundësia e hyrjes së përfitimeve ekonomike. Shuma e humbjeve të kushtëzuara njihet si provizion, nëse është e mundshme që ngjarjet e ardhshme të konfirmojnë që një detyrim ka lindur në datën e pozicionit financiar dhe mund të bëhet një vlerësim i arsyeshëm i shumës së humbjes.

4.17. Krahaseshmëria e informacionit kontabël

Kur është e nevojshme, shifrat krahasuese axhustohen (rregullohen) në konform me ndryshimet në paraqitje në periudhën aktuale raportuese. Ndryshimet janë kryer për të paraqitur më mirë natyrën e biznesit të Shoqërisë. Ato aplikohen retrospektivisht. Ndryshimet përfshijnë riklasifikime brenda zërave të seksionit të aktiveve dhe pasiveve në pasqyrën pozicionit financiar si edhe në pasqyrën të fitim humbjes.

Bursa Shqiptare e Energjisë Elektrike – ALPEX SHA
Shënime mbi pasqyrat financiare për vitin e mbyllur më 31 Dhjetor 2024

5. Aktivet afatgjata materiale

	Mjete Transporti	AAM Te tjera	Pajisje informatike	Total
Vlera bruto e AAM me 01.01.2024	2,994,000	3,809,113	7,725,180	14,528,293
Blerje të reja gjatë 2024		484,644	87,817	572,461
Pakësime		(427,193)	(56,000)	(483,193)
Rregullime		(26,685)	(49,802)	(76,487)
Vlera bruto e AAM me 31.12.2024	2,994,000	3,839,879	7,707,195	14,541,074
Amortizimi i akumuluar 01.01.2024	1,333,328	1,393,531	3,524,516	6,251,375
Amortizimi i vitit 2024	332,134	635,000	1,025,079	1,992,213
Pakësime		(157,544)	(28,438)	(185,981)
Rregullime		(23,848)	(13,105)	(36,953)
Amortizimi i akumuluar, 31 Dhjetor 2024	1,665,462	1,847,139	4,508,053	8,020,654
Vlera neto e AAM 2024	1,328,538	1,992,741	3,199,142	6,520,422
Vlera neto e AAM 2023	1,660,672	2,415,582	4,200,664	8,276,918

7. Inventarë

Balanca e inventarit të shoqërisë më 31 Dhjetor 2024 dhe 31 Dhjetor 2023 paraqitet si më poshtë:

	31.12.2024	31.12.2023
Materiale ndihmës	193,228	137,944
Lëndë djegëse	297,076	131,181
Materiale të tjera	310,000	370,000
Total	800,304	639,125
shuma		
<i>Zbritje Inventari</i>	-	
Total	800,304	639,125

8. Llogari të arkëtueshme e të tjera arkëtueshme

Gjendja e llogarive të arkëtueshme më 31 Dhjetor 2024 dhe 31 Dhjetor 2023 detajohet si më poshtë:

	31.12.2024	31.12.2023
Klientë për mallra, produkte e shërbime	116,934,081	88,702,712
Të arkëtueshme nga Dega Kosovë	2,950,902	-
Parapagimet dhe shpenzimet e shtyra	3,330,144	
Total	123,215,127	88,702,712

9. Mjete monetare në arkë e në bankë

Balancat e mjeteve monetare më 31 Dhjetor 2024 dhe 31 Dhjetor 2023 paraqiten si në vijim:

	31.12.2024	31.12.2023
Vlera monetare në Bankë		
Vlera monetare bankare, në lekë	1,601,727	64,454,876
Vlera monetare, në monedha të huaja	1,103,401,791	616,574,535
Total	1,105,003,517	681,029,411
Vlera monetare bankare, në lekë	31.12.2024	31.12.2023
<i>Raiffeisen Bank Albania</i>	1,601,727	64,454,876
Total	1,601,727	64,454,876
Vlera monetare, në monedha të huaja	31.12.2024	31.12.2023
<i>Raiffeisen Bank Albania</i>	777,589,520	613,429,079
<i>Raiffeisen Bank Kosovo</i>	43,376	2,412,062
<i>Procredit Bank Kosovo</i>	325,768,895	733,393
Total	1,103,401,791	616,574,535

Shënim: Në mjetet monetare janë përfshirë Garancitë në Para të cilat depozitohen nga Anëtarët e Klerimit në favor të ALPEX-it dhe shërbejnë për të vendosur kufirin e kreditit për Anëtarët e Bursës për të cilët kanë marrë përsipër të klerojnë transaksionet e kryera nga këta të fundit në Tregjet e ALPEX-it. Kjo vlerë për vitin e mbyllur rezulton 9,114,000.00 Euro nga të cilat 6,795,000.00 Euro janë Garancitë në Para në Shqipëri dhe 2,319,000.00 Euro janë Garancitë në Para në Kosovë.

Në mjetet monetare gjithashtu janë përfshirë Fondi i Mospërmbushjes së Detyrimeve (Default Fund), i cili depozitohet nga Anëtarët e Përgjithshëm të Klerimit dhe për vitin e mbyllur rezulton 600,000.00 Euro, përkatësisht nga 300,000.00 Euro për sejcilin vend.

10. Kapitali dhe Rezervat

Kapitali i shoqërisë më 31 Dhjetor 2024 është në vlerën 250,000,000 Lekë, i cili zotërohet nga aksionarët e shoqërisë.

	31.12.2024	31.12.2023
Kapitali aksionar	250,000,000	250,000,000
Rezerva përkthimi	877,013	(1,111,663)
Rezerva ligjore	-	-
Fitime të pashpërndara	(160,835,328)	(84,618,280)
Fitimi (humbja) e vitit financiar	(37,523,120)	(76,217,048)
Total	52,518,565	88,053,009

Kapitali aksionar i shoqërisë më 31 Dhjetor 2024 është në vlerën 250,000,000 Lekë, njësoj si edhe vitin e kaluar. Humbjet e mbartura më 31 Dhjetor 2024 janë në vlerën 160,835,328 Lekë, dhe 84,618,280 Lekë (31 Dhjetor 2023).

Rezervë përkthimi më 31 Dhjetor 2024 janë në vlerën 877,013 Lekë, (31 Dhjetor 2023 janë - 1,111,663 Lekë).

11. Llogari të pagueshme ndaj furnitorëve

Llogaritë e pagueshme ndaj furnitorëve më 31 Dhjetor 2024 dhe 31 Dhjetor 2023 detajohen si më poshtë:

	31.12.2024	31.12.2023
Furnitorë për mallra, produkte e shërbime	222,459,069	120,929,671
Total	222,459,069	120,929,671

12. Të pagueshme ndaj punonjësve dhe sigurime shoqërore

Llogaritë e Detyrimeve më 31 Dhjetor 2024 dhe 31 Dhjetor 2023 detajohen si më poshtë:

	<u>31.12.2024</u>	<u>31.12.2023</u>
Të pagueshme ndaj punonjësve dhe sig.shoqërore	967,082	507,630
Detyrime të tjera	53,511	5,489
Total	1,020,593	513,119

13. Detyrimet tatimore, TAP, Tatim në burim, TVSH etj

Detyrimet tatimore të Shoqërisë më 31 Dhjetor 2024 dhe 31 Dhjetor 2023 detajohen si më poshtë:

	<u>31.12.2024</u>	<u>31.12.2023</u>
Tatim mbi të ardhurat personale	446,798	177,314
Tatim në burim	117,639	112,618
Shteti- TVSH për tu marrë	692,571	318,062
Total	1,257,007	607,995

14. Llogari të tjera të pagueshme

Llogari të tjera të pagueshme më 31 Dhjetor 2024 dhe 31 Dhjetor 2023 përbëhen si më poshtë:

	<u>31.12.2024</u>	<u>31.12.2023</u>
Detyrime të tjera të pagueshme	4,855,032	539,674
Garanci për tregtimin energjisë	894,539,100	555,758,000
Fondi i Mospërmbushjes së Detyrimeve	58,890,000	15,582,000
Total	958,284,132	571,879,674

Shënim: Në garanci për tregtimin energjisë janë përfshirë Garancitë në Para të cilat depozitohen nga Anëtarët e Klerimit në favor të ALPEX-it dhe shërbejnë për të vendosur kufirin e kreditit për Anëtarët e Bursës për të cilët kanë marrë përsipër të klerojnë transaksionet e kryera nga këta të fundit në Tregjet e ALPEX-it. Kjo vlerë për vitin e mbyllur rezulton 9,114,000.00 Euro nga të cilat 6,795,000.00 Euro janë Garancitë në Para në Shqipëri dhe 2,319,000.00 Euro janë Garancitë në Para në Kosovë.

Në Fondin e Mospërmbushjes së Detyrimeve (Default Fund) është përfshirë Fondi i cili depozitohet nga Anëtarët e Përgjithshëm të Klerimit dhe për vitin e mbyllur rezulton 600,000.00 Euro, përkatësisht nga 300,000.00 Euro për secilin vend.

15. Të ardhura nga aktiviteti i shfrytëzimit

Të ardhurat nga aktiviteti i shfrytëzimit për periudhën e mbyllur 31 Dhjetor 2024 dhe 31 Dhjetor 2023 shoqëria është si më poshtë:

	<u>31.12.2024</u>	<u>31.12.2023</u>
Të ardhura nga aktiviteti i shfrytëzimit	65,670,136	46,547,036
Total	65,670,136	46,547,036

Lista e Tarifave të ALPEX është miratuar nga Enti Rregullator i Energjisë – ERE, dhe më i fundit është Vendimi Nr. 299 Datë 30.12.2024, për zonën e ofertimit të Republikës së Shqipërisë dhe nga Zyra e Rregullatorit për Energji – ZRRE dhe më i fundit është Vendimi Nr. V_2638_2025 Datë 27.01.2025 për zonën e ofertimit të Republikës së Kosovës.

Transaksionet e tregtimit të energjisë për periudhën e mbyllur më 31 Dhjetor 2024 dhe 31 Dhjetor 2023 paraqiten si më poshtë:

	<u>31.12.2024</u>	<u>31.12.2023</u>
Të Hyra për tregimet e energjisë	15,006,566,868	8,951,959,471
Të dala për tregimet e energjisë	(15,006,566,868)	(8,951,959,471)
Total	0	0

16. Materiale dhe shërbime direkte

Shpenzimet për materiale dhe shërbime direkte për periudhën e mbyllur më 31 Dhjetor 2024 dhe 31 Dhjetor 2023 detajohen si më poshtë:

	<u>31.12.2024</u>	<u>31.12.2023</u>
Materiale dhe shërbime direkte	1,375,665	899,615
Total	1,375,665	899,615

17. Shpenzime personeli

Shpenzimet e personelit për periudhën e mbyllur më 31 Dhjetor 2024 dhe 31 Dhjetor 2023 detajohen si më poshtë:

	<u>31.12.2024</u>	<u>31.12.2023</u>
Pagat dhe shpërblimet e personelit	28,659,989	22,773,551
Sigurimet shoqërore dhe shëndetsore	3,902,659	2,311,514
Shpenzime të tjera për personelin	1,470,500	1,880,006
	-	-
Total	34,033,148	26,965,070
Numri punonjësve	17	9

18. Shpenzime amortizimi dhe zhvlerësimi

Shpenzimet e amortizimit për periudhën e mbyllur më 31 Dhjetor 2024 dhe 31 Dhjetor 2023 detajohen si më poshtë:

	<u>31.12.2024</u>	<u>31.12.2023</u>
Amortizimi i AAM	1,992,213	2,442,342
	-	-
Total	1,992,213	2,442,342

19. Shpenzime të tjera nga veprimtaritë e shfrytëzimit

Shpenzimet për periudhën e mbyllur më 31 Dhjetor 2024 dhe 31 Dhjetor 2023 detajohen si më poshtë:

	31.12.2024	31.12.2023
Shërbime nga të tretët	-	558,542
Qera ambienti	6,441,106	6,954,748
Mirëmbajtje dhe riparime	2,829,926	3,433,280
Shpenzime për Sigurime	224,678	247,000
Personel jashtë njësisë	3,405,600	2,665,892
Trajnime per personel	153,870	285,000
Publicitet,reklama	-	-
Transferime,udhëtime,djeta	2,045,760	1,942,056
Shpenzime postare dhe telekomunikimi	738,610	834,449
Shpenzime për shërbimet bankare	987,514	289,190
Taksa dhe tarifa vendore	155,953	120,900
Taksa Doganore	50,000	-
Tatime të tjera	15,961	18,150
Shpenzime për pritje dhe përfaqësime	36,442	329,015
Gjoha dhe dëmshpërblime	4,076	6,056
Shpenzime mirmbajtje platforma	37,782,381	70,036,986
Shpenzime të tjera	7,394,384	1,516,875
Total	62,266,260	89,238,138

Shpenzimet e tjera në mënyrë më të detajuar i shprehim ne vijim:

Tarifa e Entit rregullator - 134,631 Lekë

Tarifa për Anëtarësime në Organizmat European (Europex) - 2,194,161.84 Lekë

Shpenzime për Workshope - 161,943.92 Lekë

Provizione për çështje gjyqësore - 4,758,375 Lekë

Shpenzime financiare të tjera - 145,271.94 Lekë

20. Shpenzime interesi dhe të ngjashme e të tjera financiare

Shpenzimet e tjera financiare për periudhën e mbyllur më 31 Dhjetor 2024 dhe 31 Dhjetor 2023 detajohen si më poshtë:

	31.12.2024	31.12.2023
Humbje nga këmbimet dhe përkthimet valutore	(216,579,138)	(53,804,994)
Fitim nga këmbimet dhe përkthimet valutore	213,053,169	50,586,075
Total	(3,525,969)	(3,218,919)

21. Rezultati Tatimor dhe Fitim/(Humbja)

Përlllogaritja e tatimit mbi fitimin për periudhën e mbyllur më 31 Dhjetor 2024 dhe 31 Dhjetor 2023 dhe Fitim/(Humbje) paraqitet si më poshtë:

	31.12.2024	31.12.2023
Fitimi (Humbje) para Tatimit	(37,523,120)	(76,217,048)
Shpenzime të panjohura (Gjoha e interesa tatimore)		
Shpenzime të panjohura të tjera	4,928,518	
Humbje e mbartur nga viti kaluar		
Fitimi (Humbje) Tatimore	(32,594,602)	(76,217,048)
Tatimi mbi Fitimin (15 %)		
Fitimi (Humbje) neto	(37,523,120)	(76,217,048)

22. Palët e lidhura

Balancat me palët e lidhura për periudhën e mbyllur më 31 Dhjetor 2024 dhe 31 Dhjetor 2023 detajohet si më poshtë:

Gjatë vitit dhe më 31 Dhjetor 2024	Llogari të arkëtueshme	Të ardhura	Shpenzime
OST sh.a	10,248,824	2,367,342	-
KOSTT sha.	1,146,749	4,285,750	-
	11,395,573	6,653,092	-

Gjatë vitit dhe më 31 Dhjetor 2023	Llogari të arkëtueshme	Të ardhura	Shpenzime
OST sh.a	12,510,344	3,141,199	
KOSTT sha.	-	851,816	
	12,510,344	3,993,015	-

	31.12.2024	31.12.2023
Administratori	3,240,000	3,281,840
Këshilli Mbikqyrës	3,405,600	2,665,890
Total	6,645,600	5,947,730
		Nr
Administratori	1	1
Këshilli Mbikqyrës	5	5
Total	6	6

23. Shpenzimet e panjohura

Balancat për shpenzimet e panjohura për periudhën e mbyllur më 31 Dhjetor 2024 dhe 31 Dhjetor 2023 detajohet si më poshtë:

	31.12.2024	31.12.2023
Amortizimi automjetit 50%	166,067	-
Gjoha dhe dëmshpërblime	4,076	
Provizione për çështje gjyqësore	4,758,375	
Total	4,928,518	-

Referuar Ligjit 29/2023 për “Tatimin mbi të Ardhurat”, i ndryshuar dhe Udhëzimit Nr.26 dt.08.09.2023 “Për Tatimin mbi të Ardhurat” Neni 51, pika 11 përcakton se "Baza e amortizimit për autoveturat 1+4 të personelit nuk mund të jetë më e lartë se 50% e kostove të blerjes dhe rikonstruksionit, përfshirë TVSH-në. Kostoja e plotë e autoveturës 1+4, e cila amortizohet 50%, nuk mund të jetë më e lartë se 10 000 000 lekë.". Sipas këtij neni dhe pike, kërkesa ligjore i referohet bazës së amortizimit fiskal, ku 50% e amortizimit do të jetë i njohur si shpenzim fiskal.

Shpenzimet në lidhje me provizionin për çështjet gjyqësore dhe gjoha dhe dëmshpërblime janë klasifikuar sipas legjislacionit fiskal si shpenzim i panjohur.

24. Menaxhimi i riskut financiar

Aktiviteti i kompanisë është i ekspozuar kundrejt disa risqeve financiare si: risku i kursit të këmbimit, risku i kredisë dhe risku i përqindjes së interesit. Menaxhimi i riskut financiar drejtohet dhe fokusohet në parashikueshmërinë e tregut financiar dhe synon të minimizojë efektet potenciale të papëlqyeshme. Menaxhimi i riskut financiar ndërmerret nga drejtoria financiare e kompanisë.

i. Risku nga kursi i këmbimit

Shoqëria është e ekspozuar ndaj rrezikut të kursit të këmbimit që vjen si rezultat i ekspozimit në monedha të ndryshme kryesisht në lidhje me Euro-n. Shoqëria nuk përdor ndonjë instrument për tu mbrojtur ndaj rrezikut të kursit të këmbimit. Drejtimi i shoqërisë është përgjegjës për të mbajtur pozicione neto të përshtatshme në çdo monedhë dhe në total dhe të monitorojë operacionet e përditshme.

Përshkrimi	31 Dhjetor 2024				Total
	EUR	ALL	USD	Te tjera	
Llogari tregtare të arkëtueshme dhe të tjera	119,884,983				119,884,983
Mjete monetare në arkë dhe bankë	1,103,401,791	1,601,727			1,105,003,517
Mjete monetare të kufizuara					-
Totali	1,223,286,773		-	-	1,224,888,500
Llogari tregtare të pagueshme dhe të tjera	1,175,665,695	7,355,107			1,183,020,802
Hua					-
Totali	1,175,665,695	7,355,107	-	-	1,183,020,802
Rreziku i monedhës më 31 Dhjetor 2024	2,398,952,468	7,355,107	-	-	2,407,909,301

Bursa Shqiptare e Energjisë Elektrike – ALPEX SHA
Shënime mbi pasqyrat financiare për vitin e mbyllur më 31 Dhjetor 2024

31 Dhjetor 2023

Përshkrimi	EUR	ALL	USD	Te tjera	Total
Llogari tregtare të arkëtueshme dhe të tjera	88,702,712	-	-	-	88,702,712
Mjete monetare në arkë dhe bankë	616,574,535	64,454,876	-	-	681,029,411
Mjete monetare të kufizuara					-
Totali	705,277,247	64,454,876	-	-	769,732,123
Llogari tregtare të pagueshme dhe të tjera	693,180,686	749,772	-	-	693,930,458
Hua					-
Totali	693,180,686	749,772	-	-	693,930,458
Rreziku i monedhës më 31 Dhjetor 2023	1,398,457,933	65,204,648	-	-	1,463,662,581

ii. Risku i kreditit

Rreziku i kreditit është rreziku i humbjes financiare për shoqërinë nëse klientët ose palët e tjera nuk përmbushin detyrimet kontraktuale dhe lind kryesisht nga llogaritë e arkëtueshme të shoqërisë. Ekspozimi i shoqërisë ndaj rrezikut të kreditit është kryesisht i influencuar nga karakteristikat individuale të çdo klienti.

31 Dhjetor 2024

Përshkrimi	Të pamat uruara	Deri në 6 muaj	6 deri 12 muaj	1 deri 5 vjet	Mbi 5 vjet	Total
	Non Due	Up to 6 months	6-12 months	1-5 years	> than 5 years	Total
Llogari tregtare të arkëtueshme dhe të tjera		119,884,983	-			119,884,983
Mjete monetare në arkë dhe bankë		1,105,003,517	-			1,105,003,517
Mjete monetare të kufizuara						-
Totali	-	1,224,888,500	-	-	-	1,224,888,500

31 Dhjetor 2023

Përshkrimi	Të pamat uruara	Deri në 6 muaj	6 deri 12 muaj	1 deri 5 vjet	Mbi 5 vjet	Total
	Non Due	Up to 6 months	6-12 months	1-5 years	> than 5 years	Total
Llogari tregtare të arkëtueshme dhe të tjera		88,702,712				88,702,712
Mjete monetare në arkë dhe bankë		681,029,411				681,029,411
Mjete monetare të kufizuara						-
Totali	-	769,732,123	-	-	-	769,732,123

iii. Risku i normës së interest

Të ardhurat e shoqërisë dhe fluksi monetar operues janë thellësisht të pavarura nga ndryshimet në treg të normës së interesit.

iv. Risku i Likuiditetit

Rreziku i likuiditetit përcaktohet si rreziku që një njësi ekonomike do të përballlet me vështiresi për të përmbushur detyrimet që lidhen me pasivet financiare. Drejtimi monitoron çdo ditë, javë dhe muaj duke bërë parashikime për flukset e parave.

Bursa Shqiptare e Energjisë Elektrike – ALPEX SHA
Shënime mbi pasqyrat financiare për vitin e mbyllur më 31 Dhjetor 2024

Përshkrimi	31 Dhjetor 2024				
	Deri në 6 muaj	6 deri 12 muaj	1 deri 5 vjet	mbi 5 vjet	Total
Llogari tregtare të arkëtueshme dhe të tjera	119,884,983				119,884,983
Mjete monetare në arkë dhe bankë	1,105,003,517				1,105,003,517
Mjete monetare të kufizuara					-
Totali	1,224,888,500	-	-	-	1,224,888,500
Llogari tregtare të pagueshme dhe të tjera	1,183,020,802	-			1,183,020,802
Hua					-
Totali	1,183,020,802	-	-	-	1,183,020,802
Rreziku i likuiditetit më 31 Dhjetor 2024	2,407,909,301	-	-	-	2,407,909,301

Përshkrimi	31 Dhjetor 2023				
	Deri në 6 muaj	6 deri 12 muaj	1 deri 5 vjet	Mbi 5 vjet	Total
Llogari tregtare të arkëtueshme dhe të tjera	88,702,713				88,702,713
Mjete monetare në arkë dhe bankë	681,029,411				681,029,411
Mjete monetare të kufizuara					-
Totali	769,732,124	-	-	-	769,732,124
Llogari tregtare të pagueshme dhe të tjera	693,930,458				693,930,458
Hua					-
Totali	693,930,458	-	-	-	693,930,458
Rreziku i likuiditetit më 31 Dhjetor 2023	1,463,662,582	-	-	-	1,463,662,582

25. Angazhime dhe pasiguri

Çështje gjyqësore

Gjatë aktivitetit të saj të zakonshëm, Shoqëria mund të përfshihet në pretendime apo veprime të ndryshme ligjore nga palë të treta. Bazuar në opinionin e drejtuesve të Shoqërisë, konkluzioni përfundimtar në lidhje me këto çështje nuk do të ketë efekte negative në pozicionin financiar të Shoqërisë ose ndryshime në aktivet neto të saj. Më 31 Dhjetor 2024 Shoqëria ka dy çështje gjyqësore të hapur kundrejt saj, nga dy ish punëmarrës të Shoqërisë. Vlen të theksojmë se përsa i përket zhvillimit të këtyre çështjeve deri në këtë moment janë në proces gjykimimi. Shoqëria me marrjen e një vendimi nga Gjykata e shkallës së parë dhe bazuar në afatet ligjore do ta apelojë bazuar në vendimet përkatëse. Bazuar në kërkesat është parashikuar një dëmshpërblim prej 15 paga mujore në vlerën 4,758,375.00 Lekë, shumë e cila është vendosur në provizionet e këtij viti financiar.

Detyrimet tatimore

Librat e Shoqërisë nuk janë audituar nga organet tatimore për periudhën e mbyllur më 31 Dhjetor 2024. Si rrjedhojë detyrimet tatimore nuk mund të konsiderohen përfundimtare. Detyrime të mundshme që mund të rezultojnë nga një auditim i organeve tatimore nuk mund të maten në mënyrë të besueshme.

26. Ngjarje pas datës së raportimit financiar

Deri më 28 Shkurt 2025, datë e mbylljes së pasqyrave financiare, nuk ka patur ngjarje, të cilat do të jepnin efektin e tyre në gjendjen dhe rezultatin e raportuar më 31.12.2024.

Z. Sokol Dishnica
Administrator i ALPEX SHA



Znj. Irena Sinani
Drejtore e Drejtorisë së Klerimit dhe
Financës

Tiranë, më 28/02/2025